

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca Dula kryetare, Gëzim Llulluni dhe Albert Zogaj anëtarë, në çështjen juridike të paditësve E.J., S.J.1, M.J., D.J., H.J. dhe SH.J., që të gjithë nga Gjakova, të cilët i përfaqëson i autorizuari XH.K., avokat nga Gjakova, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari D.P., jurist i diplomuar nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditësve, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.521/2010 të datës 19.09.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 26.03.2018, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I. PRANOHET pjesërisht si e themeltë ankesa e të autorizuarit të paditësve E.J., S.J.1, M.J., D.J., H.J. dhe SH.J., NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.521/2010 të datës 19.09.2014, dhe gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit jo material për dhimbjet shpirtërore për shkak të vdekjes së fëmijës S.J.2., si pasojë e aksidentit të komunikacionit të dt.25.05.2010, t'iu paguajë shumat si në vijim:

- Paditësve E.J. dhe S.J.1 në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së djalit të tyre secilit veç e veç shumën nga 5.500 Euro.

- Paditësve M.J., D.J., H.J. dhe SH.J. në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së vëllait të tyre secilit veç e veç shumën nga 4000 Euro,

- Paditësve E.J. dhe S.J.1, në emër të dëmit material për shpenzimet e varrimit shumën prej 1.500 Euro dhe shpenzimeve për ngritjen e përmendores shumën prej 1.000 Euro, e të gjitha këto me kamatë të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 19.09.2014, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.244,20 Euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve M.J., D.J., H.J. dhe SH.J., për kompensim të dëmit jo material në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së vëllait të tyre, si dhe paditësve E.J. dhe S.J.1. për kompensim të dëmit material për shpenzime të varrimit dhe shpenzimeve për ngritjen e përmendore, mbi shumat e gjykuara si në pikën I (një) të këtij aktgjykimi REFUZOHET SI E PABAZUAR.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.521/2010, 19.09.2014, me pjesën e parë të dispozitivit, kërkesëpadinë e paditësve E.J., S.J.1., M.J., D.J., H.J. dhe SH.J., me të cilën kanë

kërkuar që e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve, në Prishtinë, në emër të kompensimit të dëmit jo material ( për dhimbje shpirtërore për shkak të vdekjes së të afërmit të tyre, përkatësisht djalit dhe vëllait të tyre, të quajtur S.J.2., tani ish nga Gjakova), t`ua kompensojë, përkatësisht shumën prej nga 5.500 Euro secilit, ndërsa paditësve E.J. dhe S.J., edhe në emër të dëmit material-shpenzimeve të varrimit t`iu kompensojë shumën e përgjithshme prej 3.000 Euro, si dhe shpenzimet për ngritjen e përmendores shumën e përgjithshme prej 2.500 Euro, përkatësisht gjithë paditësve shumën totale prej 44.000,00 Euro, së bashku me shpenzimet e shkaktuara procedurale refuzohet si e pabazuar. Me pjesën e dytë të dispozitivit ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësve, për shkak të shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar ose aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën t`ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të paditësve është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit E.J., S.J.1, M.J., D. J., H. J. dhe SH. J., që të gjithë nga Gjakova, me datë 12.11.2010, nëpërmjet të autorizuarit të tyre kanë paraqitur padi për kompensimin e dëmit material dhe jo material, ndaj të paditurave Kompania e Sigurimeve "Sigma" me seli në Prishtinë, dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, të cilën e ka rregulluar dhe precizuar në aspektin subjektiv në seancën e shqyrtimit, ku tani si e paditur është vetëm Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, me kërkesë që të detyrohet e paditura që paditësve në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material t`iu paguajë shumën e përgjithshme prej 44.000,00 Euro, me kamatë ligjore duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimin e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.521/2010, të datës 19.09.2014, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në cilësi të provave materiale ka administruar Raportin Policor nr.DR-3009, i datës 25.05.2010, aktgjykimin penal të formës së prerë PM.nr.18/2010, me të cilin shkaktuesi i aksidentit K.Z. është shpallur fajtor dhe është dënuar me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 1 viti dhe është urdhëruar që ky dënim të mos ekzekutohet nëse i mituri i rritur në kohën prej 2 vitesh nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Gjykata ka arsyetuar se në rastin konkret paditësit kanë dështuar që të vërtetojnë legjitimitetin e palës pasive, respektivisht legjitimitetin e të paditurës në procedurën kontestimore, për faktin se në

rastin konkret automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti, edhe në kohën e shkakimit të aksidentit ka pasur polisë valide të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe atë të KS “SIGMA”, Prishtinë (Polica nr.2297698, datës 16.06.2009-16.06.2010, si dhe me asnjë provë materiale nuk u vërtetua fakti se vetura në fjalë të organet kompetente të jetë paraqitur si e vjedhur.

Gjykata e Apelit e aprovon pjesërisht vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Por kjo gjykatë vlerëson se me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të atakuar ka aplikim të gabuar të drejtës materiale, Rregullit 3, nenin 2 dhe 4 par.1 prej pikës a) deri në pikën g), mbi ndryshimin e rregullit për sigurime të detyrueshme të auto përgjegjësive, sa i përket vendosjes për të cilat arsye Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, që aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë.

Gjykata e Apelit, pasi ka vlerësuar pretendimet ankimore të autorizuarit të paditësve, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar pjesërisht ankesën e paditësve dhe ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe e ka detyruar të paditurën që paditësve t’ua kompensojë dëmin material dhe jo material, pasi që vetura me të cilën është shkaktuar aksidenti, ndonëse ka qenë e siguruar te Kompania e Sigurimeve “Sigma” me seli në Prishtinë, dhe ka pasur mbulesë siguruese, por nëse e marrim parasysh Rregullin 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësive, të nxjerrë nga Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, datë 20 janar, 2006, në nenin 4 par.1, pika e), (i aplikueshëm në rastin konkret) ka përcaktuar se *“Mjetet nga fondi garantues do të përdoren për pagesën e dëmeve të shkaktuara: (pika e) nga përdorimi i automjetit të përdorur pa autorizim nga personi që ka marrë në posedim në kundërshtim me ligjin dhe rregullat”, e* që në rastin konkret përmbushen të gjitha kushtet për aplikimin e kësaj dispozite, pasi që personi i cili e ka drejtuar automjetin, ka qenë person i moshës së mitur i rritur dhe nuk ka mundur të ketë as pëlqimin dhe as autorizimin për të drejtuar automjetin, fakt që është vërtetuar edhe nga aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, PM.nr.18/2010, të datës 16.02.2011, i marrë në çështjen penale të zhvilluar ndaj të miturit madhor, i cili e ka shkaktuar aksidentin. Bazuar në këtë dispozitë të lartcekur, e në veçanti të shkresës së Bankës Qendrore të Kosovës të datës 04.09.2012, përgjegjësia për kompensimin e dëmit në raport me paditësit për aksidentin e shkaktuar të datës 25.05.2010, si pasojë e të cilit ka vdekur S.J.2., (fakt i cili nuk është kontestues), është ekskluzivisht e të paditurës “Byroja Kosovare e Sigurimit”, me seli në Prishtinë, andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, shumat e gjykuara, për shkak të dhimbjeve shpirtërore të shkaktuara nga vdekja e djalit/vëllaut, të paditësve në aksidentin të komunikacionit të datës 25.05.2010, të cilët kanë përjetuar vuajtje shpirtërore të intensitetit të lartë, që është e natyrshme me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes djalit/vëllaut 2 vjeçar, e të cilat vuajtje shpirtërore kanë kaluar me një intensitet më të ulët, e që vazhdon edhe sot e kësaj dite, andaj gjykata me rastin e aprovimit pjesërisht të kërkesëpadisë dhe vendosjes lidhur me lartësinë e dëmit jo material, ka vendosur sipas vlerësimit të lirë, e në kuptim të nenit 200 dhe 201 paragrafi 1 të LMD-së si dhe nenit 323 të LPK-së, në bazë të të cilave dispozita ekziston e drejta e kompensimit të paditësve në raport me të paditurën, për dëmin e shkaktuar për dhimbjet e përjetuara shpirtërore me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes.

Gjykata e Apelit, ka vendosur lidhur me shumat e gjykuara, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh të mirën e dëmtuar, si dhe duke marrë për bazë të gjitha rrethanat, raportin familjar, pasojat dhe përjetimet që kanë përjetuar paditësit pas vdekjes së të ndjerit, e që këto shuma do të jenë një satisfakcion për paditësit për zbutjen sado pak të dëmit të shkaktuar, ndërsa sa i përket shumave të aprovuara sa i përket dëmit material për shpenzimet e varrimit dhe për ngritjen e përmendores, gjykata vlerëson se shumat e gjykuara janë në proporcion me shpenzimet e krijuara për këtë lloj të dëmit, e duke u bazuar edhe në praktikën e mirë të gjykatave, konsideron se janë të mjaftueshme për kryerjen e procedurës së varrimit dhe për ngritjen e përmendores.

Gjykata e Apelit, ka vendosur lidhur me kamatën, konform dispozitës së nenit 277 paragrafi 1 të LMD-së, për shumat e gjykuara për dëmin jo material dhe material, e që e ka obliguar të paditurën që paditësve t'ua paguajë dëmin material dhe jo material në shumat e gjykuara, me kamatë të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 19.09.2014, e deri në pagesën definitive.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që i referohet dëmit jo material për paditësit M.J., D. J., H. J. dhe SH. J., përtej shumës së aprovuar për këtë kategori të dëmit gjykata vlerësojë se kërkesëpadia nuk ishte në harmoni me qëllimin e kompensimit për dëmin jo material. Ndërsa lidhur me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë për dëmin material për paditësit E.J., S.J.1. që i referohet shpenzimeve të varrimit dhe shpenzimeve për ngritjen e përmendores, Gjykata e Apelit një kërkesë të tillë e refuzoi për shkak se ka vlerësuar se shumat e kërkuara nuk janë në harmoni me praktikën e mirë gjyqësore si dhe nuk janë ekuivalente me shpenzimet e krijuara.

Gjykata e Apelit, i ka gjykuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore, duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së, ashtu që e ka obliguar të paditurën që ti kompensojë edhe shpenzimet e procedurës, në shumë totale prej 1.244,20 Euro, edhe atë: 208 Euro për përpilimin e padisë, nga 270.40 Euro për tri seanca të mbajtura gjyqësore, 100 Euro taksë për padi dhe 100 Euro taksë për aktgjykim.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 194, 195 pika dhe e), e lidhur me nenin 201 të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.4675/14, më datë 26.03.2018**

**Kryetare e kolegjit**

**Nora Bllaca Dula**